



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:122333

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05761413

PKR.nr.40/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Mentor Hajraj, me zyrtaren ligjore Arijana Bislmi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.S, për shkak të veprës penale: Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 1 të KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.48/24, e datës 10.05.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar më datë 24.05.2024, i cili ishte i hapur për publikun, në të cilin kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari S.S dhe mbrojtësi i tij me autorizim av.Kadri Osaj, me datën 24.05.2024, në prezencën e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ka shpallur, ndërsa më datë 31.05.2024, ka përpiluar me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: S.S, nga i ati S..., e ëma H..., e gjinisë N..., i lindur me datë, në fshatin ... – Komuna e Novi Pazari, ku edhe jeton, me numër personal të letërnjoftimit *****, boshnjak, shtetas i Republikës së Serbisë, i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion, ka të kryer shkollën e mesme, gjendet nën masën e paraburgimit nga data 24.04.2024.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 24.04.2024, rreth orës 11:00 në parkingun e Terminalit Doganor në Mitrovicë, i pandehuri S.S, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka jap dhuratë personit zyrtar, në mënyrë që ai të mos veproj në pajtim me detyrën e tij zyrtare, ashtu që i pandehuri deri sa ka qenë në Terminalin Doganor në Mitrovicë me kamionin e tij ...-...-..., me qëllim të lehtësimit të procedurave për lirim të mallit i kishte dhënë të pandehurit Q.M 135 euro, duke i futur në xhepin e djathtë të palltës, të cilat para janë konfiskuar nga ana e të pandehurit të parë Q.M, nga ana e policisë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 7, 17, 21, 38, 42, 43, 69 të KPRK-së, lidhur me nenet 360 dhe 364 të KPP-së:

S H Q I P T O N

I. DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merre formën e prerë dhe dënim me GJOBE në lartësi prej katërqind (400) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 90 ditëve, pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë.

II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë ky dënim ne baze te nenit 43 par.3 te KPRK-se, do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për njëzetë (20) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë një (1) ditë burg.

III. Te akuzuarit, Gjykata me vendimin e veçante i ka vazhduar masë e paraburgimit, nga dt.24.05.2024, derisa ky aktgjykim të merr formën e prerë, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e kësaj gjykate.

IV. Te akuzuarit koha e kaluar ne masën e paraburgimit prej dt.24.04.2024,i llogaritet ne dënimin e shqiptuar me burgim.

V. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 30€ (tridhjetë euro), paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

VI. Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk pati, andaj për realizimin e kërkesën pasurore juridike, gjykata nuk vendosi fare.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.48/24, e datës 10.05.2024, kundër të akuzuarve Q.M për shkak të veprës penale Marrja e ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK-së dhe të akuzuarit S.S, për shkak të veprës penale: Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 1 të KPRK-se.

Në këtë çështje penale është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me datën 24.05.2024, në të cilën ka prezantuar Prokurorja e Shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari S.S dhe mbrojtësi i tij me autorizim av.Kadri Osaj, i akuzuari Q.M dhe mbrojtësit e tij me autorizim av.Avdi Dinaj dhe av.Gazmend Smajli.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 24.05.2024, pasi që prokurorja e shtetit ka lexuar aktakuzën i akuzuari S.S është deklaruar fajtor për veprën penale për te cilën ai akuzohej, ndërsa i pandehuri Q.M është deklaruar i pafajshëm për veprën penale për te cilën akuzohej sipas aktakuzës.

Gjykata, me qëllim të mos zvarritjes së procedurës dhe ekonomizimit të saj, në kuptim të nenit 242 par.7 lidhur me nenin 332 par.5 e lidhur me nenin 35 të KPP-së ka bërë veçimin e procedurës për të pandehurin Q.M.

Prokurorja e Shtetit sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari S.S i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që këtë pranim i akuzuari e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe është në përputhje me shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i te akuzuarit av.Kadri Osaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, i ka propozuar gjykatës që te miratoje pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi i njëjti është bërë nga vullneti i lirë.

Pas marrjes së mendimit nga Prokurorja e Shtetit dhe mbrojtësi i te akuzuarit, Kryetari trupit gjykues është bindur se i akuzuari S.S, e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj Kryetari i trupit gjykues në procesverbal në kuptim të nenit 242 par.2 e lidhur me par.6 të KPP-së, ka marrë aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale.

Prokurori i Shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, nuk kanë pasur propozime apo plotësime në këtë çështje penale dhe pasi që Gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë për veprën penale nga i akuzuari dhe meqenëse nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës, Kryetari trupit gjykues e ka shpallur përfundimin e shqyrtimit fillestar dhe i ka njoftuar palët se gjykata do të vazhdojë në mbështetje të nenit 242 par.6 të KPP-së me shqiptimin e dënimit-respektivisht me shpalljen publike të aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bërë me datën 24.05.2024, shpallja ka qenë e hapur dhe publike, në prezencë të akuzuarit, mbrojtësit të akuzuarit.

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i akuzuari në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 360 të KPP-së, Gjykata vërtetohet se ekzistojnë prova se në veprimet e të akuzuarit kemi të bëjmë me elementet e veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, me të cilën akuzohet sipas aktakuzës, kjo konstatohet nga provat që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: Vendimi i dt.25.04.2024 nga ATK, raporti i policit Sami Kurti, raporti i policit Zharko Kosovac, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i dt.24.04.2024 dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vërtetohet se nga këto prova, provohet se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Duke vlerësuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të akuzuarit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin për të përjashtuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit në këtë çështje.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, Gjykata si rrethanë lehtësuese vlerësoj pranimin e fajësisë nga i akuzuarit, shprehjen e keqardhjes se i akuzuari është penduar për veprën të cilën e ka kryer, bashkëpunimin e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale, ndërsa rrethane renduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të të akuzuarit.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i akuzuari dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të

KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Ne baze të nenit 79 par.1 të KPRK-se, të akuzuarit koha e kaluar në masën e paraburgimit prej dt.24.04.2024, deri me dt.24.05.2024, i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobe.

Të akuzuarit, Gjykata me vendimin e veçantë i ka vazhduar paraburgimin nga data 24.05.2024, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo me shume se dënimi i shqiptuar me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 dhe 452 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 36 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk pati, andaj gjykata për kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

Nga të cekurat si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.40/2024, të datës 31.05.2024

Procesmbajtësja:

Arijana Bislimi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari

Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.